

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

SikaCeram® StarGrout

BOJAK EPOKSID ME 2 PËRBËRËS PËR FUGA ME GJERËSI 1-15 MM

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

SikaCeram® StarGrout është bojak me 2 përbërës dhe me bazë rrëshire epokside që ofron një sipërfaqe të lëmuar dhe të shkëlqyeshme në ngjyra të ndryshme. Është ideal për aplikime në zona ku kërkohet pastërti e përkryer.

Si bojak, kategoria RG sipas EN 13888.

Si kollë pllakash, kategoria R2 T sipas EN 12004.

PËRDORIMET

SikaCeram® StarGrout është i përshtatshëm për ngjitjen e llojeve të mëposhtme të pllakave:

- Pllaka qeramike
- Mozaik qeramik, qelqi, mermeri, druri
- Mermerë dhe gurë të tjerë natyrorë

Si kollë pllakash mbi sipërfaqet e mëposhtme, në mure dhe dysheme në mjedise të brendshme e të jashtme:

- Nënshtrës gipsi ose me bazë çimentoje
- Bojra të vjetra
- Pllaka të vjetra
- Hekur
- Plastik i përforcuar me fibra qelqi

Për këto zona përdorimi:

- Pishina (përfshirë pishinat me ujë deti), pishina termale, banja turke, banja private dhe publike
- Kuzhina
- Baxho, fabrikë lëkurash, fabrika letre, laboratorë të të gjitha llojeve, thertore, kuzhina profesionale, etj.

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Rezistencë kimike e mirë
- Punueshmëri e shkëlqyer: aplikim dhe pastrim i lehtë
- I fortë
- Absorbueshmëri shumë e ulët uji
- Rezistencë ndaj njollave
- Kundër ngricës
- Shmang krijimin e mykut
- Rezistencë ndaj abrazionit

MIRATIME / STANDARDE

Kollë rrëshire me performancë të përmirësuar me rrëshqitje të reduktuar, kategoria R2T sipas EN12004:2007. Deklaratë Performance nr. 50124663 vlerësuar nga laborator i njoftuar 1599 dhe mbart markën CE.

Testime pajtueshmërie për kategorinë RG në përputhje me EN 13888.

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Rrëshirë epokside, agregate kuarci dhe aditivë specifike.		
Ambalazhi	Kovë plastike 3 kg (A+B).		
Paraqitja / Ngjyra	Përbërësi A	Pastë e dendur me ngjyrë	
	Përbërësi B	Lëng viskoz	
	Disponohet në 10 ngjyra		
	White	Light grey	Manhattan
	Anthracite	Jasmine	Beige
	Dark brown	Total black	Ash
			Caramel
Jetëgjatësia	24 muaj nga data e prodhimit		

Kushtet e magazinimit	Në vend të thatë, në temperatura midis 10°C dhe 30°C, në ambalazhin original dhe të padëmtuar.	
Dendësia	Dendësia e llaçit të freskët: ~1.7 kg/l	
Përmasa maksimale e kokrrizës	Dmax: 0.2 mm	

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj abrazionit	$\leq 250 \text{ mm}^3$	(EN 12808-2)									
Rezistenca ndaj ngjeshjes	<table border="0"> <tr> <td>Pas magazinimit në kushte të thata</td> <td>$\geq 45 \text{ N/mm}^2$</td> <td>(EN 12808-3)</td> </tr> <tr> <td>Pas cikleve ngrirje-shkrirje</td> <td>$\geq 45 \text{ N/mm}^2$</td> <td></td> </tr> </table>	Pas magazinimit në kushte të thata	$\geq 45 \text{ N/mm}^2$	(EN 12808-3)	Pas cikleve ngrirje-shkrirje	$\geq 45 \text{ N/mm}^2$					
Pas magazinimit në kushte të thata	$\geq 45 \text{ N/mm}^2$	(EN 12808-3)									
Pas cikleve ngrirje-shkrirje	$\geq 45 \text{ N/mm}^2$										
Rezistenca ndaj tërheqjes në përkulje	<table border="0"> <tr> <td>Pas magazinimit në kushte të thata</td> <td>$\geq 30 \text{ N/mm}^2$</td> <td>(EN 12808-3)</td> </tr> <tr> <td>Pas cikleve ngrirje-shkrirje</td> <td>$\geq 30 \text{ N/mm}^2$</td> <td></td> </tr> </table>	Pas magazinimit në kushte të thata	$\geq 30 \text{ N/mm}^2$	(EN 12808-3)	Pas cikleve ngrirje-shkrirje	$\geq 30 \text{ N/mm}^2$					
Pas magazinimit në kushte të thata	$\geq 30 \text{ N/mm}^2$	(EN 12808-3)									
Pas cikleve ngrirje-shkrirje	$\geq 30 \text{ N/mm}^2$										
Tkurrja	$\leq 2 \text{ mm/m}$	(EN 12808-4)									
Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje	<table border="0"> <tr> <td>Fillestare</td> <td>$\geq 3.0 \text{ N/mm}^2$</td> <td>(EN 12003)</td> </tr> <tr> <td>Zhytje në ujë</td> <td>$\geq 2.0 \text{ N/mm}^2$</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Shok termik</td> <td>$\geq 2.0 \text{ N/mm}^2$</td> <td></td> </tr> </table> <p>Të gjitha të dhënat janë mbledhur nga raporte testimesh të lëshuara nga laboratorit Modena Centro Prove, Organ i Njoftuar nr. 1599.</p>	Fillestare	$\geq 3.0 \text{ N/mm}^2$	(EN 12003)	Zhytje në ujë	$\geq 2.0 \text{ N/mm}^2$		Shok termik	$\geq 2.0 \text{ N/mm}^2$		
Fillestare	$\geq 3.0 \text{ N/mm}^2$	(EN 12003)									
Zhytje në ujë	$\geq 2.0 \text{ N/mm}^2$										
Shok termik	$\geq 2.0 \text{ N/mm}^2$										
Rezistenca kimike	Rezistencë ndaj shumë kimikateve. Kontaktoni me shërbimin teknik të Sika-s për informacione specifike.										
Përthithja e ujit	Pas 240 min $\leq 0.1 \text{ g}$	(EN 12808-4)									
Rezistenca ndaj rrëshqitjes	$\leq 0.5 \text{ mm}$	(EN 1308)									
Temperatura e funksionimit	-20 °C min. / +100 °C max.										
Gjerësia e fugës	1–15 mm										

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzierjes	Përb. A : Përb. B = 94 : 6
-----------------------------	----------------------------

Konsumimi

Si kollë pllakash

Konsumimi varet nga profili i sipërfaqes dhe ashpërsia e nënshtresës, si dhe gjithashtu nga teknika e aplikimit (përhapje e kollës mbi nënshtresë ose edhe në pjesën e pasme të pllakës).

Si udhëzues, konsumimi me përafërsi jepet në tabelën e mëposhtme:

Madhësia e pllakës	Madhësia e mallës krëhër	Konsumimi
Të vogla	6 mm	~2 kg/m ²
Mesatare	8 mm	~2.5 kg/m ²
Të mëdha	10 mm	~3 kg/m ²

Si bojak pllakash

Konsumimi varet nga profili i sipërfaqes dhe ashpërsia e nënshtresës, si dhe gjithashtu nga madhësia e pllakave dhe fugave midis tyre. Si udhëzues, konsumimi me përafërsi jepet në tabelën e mëposhtme, shprehur në g/m².

Përmasat e pllakës (cm)	1 mm	5 mm	10 mm	15 mm
Mozaik qelqi	519			
5 × 5 × 0.4	264	1180	2078	2 776
10 × 10 × 0.6	201	948	1770	2 487
15 × 15 × 0.9	202	971	1853	2 655
20 × 20 × 0.9	152	737	1422	2 060
30 × 30 × 1	113	553	1079	1 580
30 × 60 × 1	85	417	818	1 204
50 × 50 × 1	68	335	660	976
60 × 120 ×	47	231	459	681
1.1				

Konsumimi mund të përlllogaritet gjithashtu me formulën e mëposhtme:

$$S \times [(a+b+l)/(a+l)(b+l)] \times l \times h \times d \times 10\,000$$

S = sipërfaqja e plotë (m²)

h = trashësia e pllakës (cm)

a, b = përmasat e pllakës (cm)

d = dendësia e llaçit të freskët (kg/l)

l = përmasa e fugës (cm)

Temperatura e mjedisit	+10 °C min. / +30 °C max.	
Temperatura e nënshtresës	+10 °C min. / +30 °C max.	
Koha e punueshmërisë	~45 min	
Koha e pritjes	Përpara mbushjes së fugave në:	Koha e pritjes
	Pllaka dyshemeje të ngjitura me kollë me mpiksje normale	24-36 orë
	Pllaka dyshemeje të ngjitura me kollë me mpiksje të shpejtë	4-6 orë
	Pllaka dyshemeje të ngjitura me metodën tradicionale (llaç në trashësi të madhe)	8-10 ditë
	Pllaka muri të ngjitura me kollë me mpiksje normale	4-6 orë
	Pllaka mbi mur të vendosura me kollë që mpikset shpejtë	2 orë
Produkti i aplikuar gati për përdorim	Përdorimi	Koha e pritjes
	Qarkullim këmbësorësh	24-36 orë
	Trafik i plotë	~7 ditë
	Zhytje në ujë	~7 ditë

Vlera të përfuara në kushte laboratorike: 23°C ± 2°C, lagështi relative 50 % ± 5 %. Temperaturat më të larta reduktojnë kohët e treguara, ndërsa temperaturat e ulëta i zgjasin.

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Nënshtresat duhet të jenë maturuar sipas mënyrës së duhur, të kenë strukturë të qëndrueshme, të jenë të pastra, të thata dhe pa kontaminues si pluhur, papastërti, vaj, graso, kore çimentoje (qumësht), efloreshencë, veshje të mëparshme apo çdo trajtim të sipërfaqes apo pengesa si kollë e tepërt pllakash, kryqe plastikë për fugat e pllakave, etj.

Në varësi të kontaminuesve që do të hiqen, kryeni teknika të mjaftueshme përgatitjeje, si pastrimi me curril uji ose me rrymë ajri, për të larguar të gjitha gjurmët e materialeve që mund të reduktojnë lidhjen e produktit me nënshtresën.

PËRZIERJA

SikaCeram® StarGrout është produkt reaktiv. Kjo do të thotë se mpikset nëpërmjet reaksionit kimik ndërmjet 2 përbërësve A dhe B. Prandaj dhe është thelbësore të sigurohet se këta 2 përbërës janë përzierë në mënyrë të njëtrajtshme në raportin e saktë të përzierjes. Hidhni të gjithë forcuesin (Përb. B) brenda enës me pastë (Përb. A) dhe përzieni me një mikser elektrik me spirale në shpejtësi të ulët (~500 rpm.). Përzieni plotësisht derisa materiali të jetë plotësisht homogjen dhe pa kokrriza. Miksi përfundimtar ka konsistencë shumë kremoze, ngjyrë të njëtrajtshme si dhe aplikohet dhe përhapet me lehtësi. Për aplikimet ku sipërfaqja përfundimtare duhet të ketë glitter (varak), shtoni varakun tek miksi përfundimtar i pastës dhe përzieni derisa të shpërndahen në mënyrë të njëtrajtshme.

APLIKIMI

Bojak pllakash

- SikaCeram® StarGrout aplikohet me shpatull gome ose shpatull duke u kujdesur se fugat janë mbushur në mënyrë të njëtrajtshme në të gjithë gjatësinë, thellësinë dhe gjerësinë e tyre.
- Në vazhdim, duke përdorur të njëjtën vegël por në pozicion vertikal, hiqni tepicën nga pllakat.
- Kur produkti është mpiksur, është e mundur të fillojë pastrimi. Shtrydhni sfungjerin e zhytur në ujë mbi sipërfaqen që është mbushur me bojak dhe kryeni lëvizje rrethore që produkti të emulsifikohet, duke u kujdesur për të mos dëmtuar fugën.
- Shpëllani shpesh sfungjerin me ujë të freskët gjatë pastrimit.
- Pas pastrimit, kontrolloni me kujdes nëse pllakat janë plotësisht pa asnjë gjurmë bojaku. Pas tharjes, produkti mund të hiqet vetëm mekanikisht.

Kollë pllakash

- SikaCeram® StarGrout aplikohet me mallë krëhër.
- Aplikoni mjaftueshëm produkt për të siguruar mbulimin e plotë të pjesës së pasme të pllakave.
- Shtrimi i pllakave duhet kryer mbi kollën e freskët duke ushtruar presion të mjaftueshëm për të siguruar kontakt të plotë dhe të njëtrajtshëm me kollën dhe kështu një ngjitje të shkëlqyer.
- Nëse vërehet se mbi sipërfaqe është formuar cipë, kjo gjë tregon se kolla është lënë për shumë kohë. Në

këtë rast, hiqni shtresën e kollës me mallë, hidhni këtë material dhe aplikoni një shtresë të freskët kolle SikaCeram® StarGrout.

- Shmangni aplikimin në rrezatim të drejtpërdrejtë diellor dhe/ose në erë të fortë.
- Për shtrimin e pllakave më të mëdha se 900 cm² (p.sh. 30x30 cm), rekomandohet gjithnjë teknika e aplikimit në 2 shtresa (mbi nënshtresë dhe në pjesën e pasme të pllakës).

Të mbrohet nga kushtet e pafavorshme të motit, si temperaturat ekstremisht të larta ose të ulëta (ngjirje), shiu, ekspozimi i drejtpërdrejtë në diell për të paktën 12-24 orë pas aplikimit.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni plotësisht të gjitha veglat dhe pajisjen me ujë të pastër përpara se të jetë mpiksur produkti, preferohet menjëherë pas përdorimit. Pas ngurtësimit produkti mund të hiqet vetëm mekanikisht.

KUFIZIME

- Kryeni gjithmonë një testim rreth lehtësisë për pastrim dhe njollosjes përpara mbushjes së pllakave prej guri natyror ose çdo veshjeje prej sipërfaqeje poroze ose absorbuese.
- Në rastin e pllakave me sipërfaqe të strukturuar, përdorni një copë të butë për të emulsifikuar produktin gjatë pastrimit.
- Kryeni gjithmonë një testim paraprak rreth lehtësisë për pastrim në rast aplikimi në pllaka me kontrast ngjyrash.
- Mos shtoni tek produkti asgjë që nuk specifikohet në këtë skedë teknike.

SikaCeram® StarGrout nuk duhet të aplikohet në situatat e mëposhtme:

- Për çdo aplikim që nuk përkrahë në mënyrë eksplicite në këtë skedë teknike.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

SikaCeram® StarGrout

Prill 2019, Botimi 02.02

020404010020000013

SikaCeramStarGrout-sq-AL-(04-2019)-2-2.pdf